



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Biznes dhe Ekonomi (2021/2022)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Kodi	BA-180
Titulli	Ekonomist i diplomuar - Drejtimi: Analitikë Biznesi
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-7/6
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	20.08.2021

Përshkrimi i programit

Gjatë studimeve të Biznes analitikës, studentët do t'i fitojnë aftësitë e nevojshme për të zgjidhur problemet sfiduese të biznesit në mënyrë analitike duke përdorur një qasje multidisiplinare. Më konkretisht, në programin e Biznes analitikës, studentët do të përqendrohen në menaxhimin dhe optimizimin e proceseve të biznesit. Ato do të njoftohen me ekonominë e biznesit si dhe fushat e ndryshme funksionale në kompani (p.sh. kontabiliteti, menaxhimi financiar, marketingu, prodhimi dhe logjistika, menaxhim i burimeve njerëzore). Studentët do të mësojnë se si kompania operon çdo ditë dhe si organizohen proceset e saj përmes teknologjisë.

Karriera

Programi i studimit korrespondon me nevojat e tregut të punës. Si i tillë, ai do të japë një kontribut të rëndësishëm në trajnimin e studentëve për të ndërtuar një karrierë profesionale duke marrë kualifikime të arsimit të lartë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Studentët vihen përballë një karriere premtuese (ndërkombëtare) falë njohurive aktuale në kombinimin e ekonomisë së biznesit, metodave kuantitative dhe teknologjisë, aftësive të menaxhimit dhe aftësive IT dhe atyre gjuhësore.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Të zotërojë njohuri dhe kuptim të mjedisit të biznesit, subjekteve të biznesit dhe operacioneve të tyre në kontekstin e biznesit të aplikuar (ekonomi, menaxhim, marketing, financa, programim, baza të dhënash, sisteme kompjuterike dhe informacioni, rrjete dhe inxhinieri e të dhënave)

Aftësi për të zhvilluar dhe zbatuar ide origjinale dhe krijuese në mjedise në të cilat fushat e biznesit të aplikuar mbivendosen ose ndërliken.

Aftësi për të aplikuar njohuri ndërdisiplinore dhe për të demonstruar kompetenca të specializuara në biznesin e aplikuar.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Aftësi për zgjidhje kritike, të pavarur dhe krijuese të problemeve në mjedise të reja ose në situata në të cilat studentët nuk do të kenë përvojë në kontekst multi-disiplinor për situatën reale të biznesit ose mjedisin organizativ. Planifikimi, udhëheqja dhe vlerësimi i pavarur i kërkimeve në fushën e biznesit, duke zbatuar vegla, mjedise dhe teknologji përkatëse.

Krijueshmëria dhe origjinaliteti gjatë interpretimit të dijes nga proceset e biznesit dhe përdorimi i duhur i mjeteve kompjuterike të bazuara në teknika të përcaktuara për kërkim dhe ekzaminime. Posedon njohuri për të filluar dhe për të zhvilluar biznes personal.

Aftësitë për të vlerësuar

Aftësi për integrim dhe sintezë krijuese të njohurive nga fusha të shumta që lidhen me proceset e biznesit dhe përdorimin e mjeteve dhe teknikave kompjuterike.

Aftësia për t'u marrë me situata komplekse në lidhje me proceset e biznesit, për të identifikuar instancat e përshtatshme të specializuara në fushën e biznesit dhe informatikës dhe për të bërë vlerësime të shëndosha në situata të mungesës së informacionit të plotë ose të dhënave dhe bazuar në parimet personale, shoqërore dhe etike; dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e njohurive dhe të kuptuarit.

Merr vendime biznesi në menaxhim të nivelit të ulët.

Ka aftësinë për të analizuar konkurrencën e tregut.

Aftësitë e komunikimit

Aftësia për të paraqitur qartë dhe pa dyshim konkluzione, rezultate, studime dhe njohuri të ekspertëve me aftësinë për të rregulluar stilin dhe formën e shprehjes.

Kompetencë për kërkime kritike, të pavarura dhe të arsyetuara në mënyrë krijuese, vlerësimin e metodologjive dhe propozimin dhe mbrojtjen e hipotezave të reja.

Aftësia për të filluar, udhëhequr dhe marrë përgjegjësi për individët dhe grupet në rastet kur kompetencat e biznesit dhe kompetencat e TI janë thelbësore.

Aftësi për të paraqitur rezultatet e studimeve të ndryshme, për të transmetuar planet e biznesit tek grupet e punës dhe palët e interesit.

Aftësitë e të mësuarit

Aftësia për të identifikuar nevojat personale dhe drejtimet për arsimimin e mëtejshëm individual dhe autonom, si dhe për zbatimin e tij të pavarur dhe autonom në fushat e zakonshme të biznesit dhe informacionit.

Aftësia për të marrë përgjegjësi për vazhdimin e mësimin individual në fusha të specializuara të biznesit dhe IT brenda një ekonomie në rritje.

Përdor aftësitë kompjuterike për të fituar njohuri juridike.

Mund të ndërmarrë mësim individual dhe ekipore.

Ka aftësinë për të bërë analiza të biznesit dhe për të përdorur literaturë shkencore dhe vlerësime nga autorë të tjerë.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [C2118] [6.0 SETK] **Matematikë**
- [C2119] [6.0 SETK] **Parimet e menaxhmentit**

- [C2117] [6.0 SETK] **Bazat e ekonomisë për biznes**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore - Kompetencat digjitale**

Semestri 2

- [CBE-102] [6.0 SETK] **Parimet e marketingut**
- [CBE-203] [6.0 SETK] **Mikroekonomia**
- [C2292] [6.0 SETK] **Kalkulus**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore - Kompetencat digjitale**

Semestri 3

- [C2069] [3.0 SETK] **Komunikimi verbal**
- [CBE-301] [6.0 SETK] **Statistika**
- [CBE-303] [6.0 SETK] **Makroekonomia**
- [C2121] [3.0 SETK] **Biznesi, Qeveria dhe Shoqëria**
- [B?-410] [6.0 SETK] **E drejta tregtare**
- [C2120] [3.0 SETK] **Parimet e kontabilitetit**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 4

- [CBE-401] [6.0 SETK] **Menaxhimi i operacioneve**
- [C2122] [3.0 SETK] **Menaxhmenti i burimeve njerëzore**
- [C2123] [3.0 SETK] **Ekonomia për menaxher**
- [C2124] [6.0 SETK] **Sistemet informative të biznesit**
- [CBE-402] [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar**
- [C2070] [3.0 SETK] **Komunikim me shkrim**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 5

- [CBEF-602] [6.0 SETK] **Financat publike**
- [C2127] [3.0 SETK] **Kontabiliteti menaxherial**
- [C2126] [3.0 SETK] **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**
- [C2125] [6.0 SETK] **Marketingu strategjik**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 6

- [C2128] [6.0 SETK] **Strategjia dhe organizimi**
- [CBM-502] [6.0 SETK] **Financat e korporatës**
- [C2129] [3.0 SETK] **Paratë, bankat dhe tregjet financiare**
- [C2130] [3.0 SETK] **Biznesi ndërkombëtar**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Matematikë**
Lënda ka për qëllim që t'i zgjeroj njohuritë themelore nga matematika dhe të zhvilloj aftësitë dhe shkathtësitë e studentëve në zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe aplikimin e tyre në fushën e biznesit dhe ekonomisë.

Gjithashtu qëllim i dytë është aftësimi i studentëve në përdorimin e programeve aplikative për zgjidhjen e detyrave dhe problemeve të zbatuara në fushën e biznesit dhe ekonomisë. Temat që trajtohen në këtë lëndë janë: bashkësitë numerike, shprehjet numerike dhe variabla, ekuacionet lineare dhe jolineare, matricat, përcaktorët, sistemet e ekuacioneve lineare, zbatimin e sistemeve të ekuacioneve lineare në biznes dhe ekonomi, vargjet, progresioni aritmetik dhe gjeometrik, seritë numerike, njehsimi proporcional, interesi i thjeshtë, interesi i përbërë, depozitave periodike, rentave periodike, huatë dhe plani i amortizimit të huave, metoda të ndryshme për amortizimin e huave.

• **Parimet e menaxhmentit**

Lënda ka për synim njohimin e studentëve me esencën e menaxhmentit dhe krijimin e një baze e cila do të plotësohet nga lëndët tjera menaxheriale dhe organizative që studentët do të dëgjojnë gjatë studimit të tyre. Kjo lëndë ka disa qëllime kryesore, edhe atë: - Studentët t'i kuptojnë dhe sqarojnë konceptet dhe teoritë kryesore të menaxhmentit. - Të inicohet mendimi kritik në klasë. - Të aftësohen studentët që informatat e fituara të shfrytëzohen për të dhënë vlerësime dhe për të konstruktuar argumente. - Të zhvillohen aftësitë komunikuese të studentëve. - Të informohen studentët me procesin e menaxhmentit dhe detyrat e menaxherit. - Të informohen studentët me procesin e planifikimit. - Të informohen studentët me proceset dhe modelet e vendim marrjes. - Të njohet studentët me organizimin, përfshirë këtu edhe ndarjen e punës dhe gjerësinë dhe thellësinë e menaxhmentit. - Studentët të jenë në gjendje që në praktikë të zbatojnë njohuri mbi relacionet individ-organizatë dhe elementet e ndryshme që kanë të bëjnë me sjelljen organizative, duke përfshirë këtu personalitetin, sjelljet dhe perceptimet. - Studentët të fitojnë njohuri mbi motivimin dhe teorinë e motivimit.

• **Bazat e ekonomisë për biznes**

Lënda ka për qëllim të njoftojë studentët për konceptet dhe njohuritë bazike nga lëmitë e ekonomisë dhe biznesit. Ligjeratat përfshijnë temat siç janë: kuptimi mbi ekonominë dhe biznesin, pse mësohet ekonomia, ndarja e saj në degët mikro dhe makro ekonomi, metodat që përdoren në hummtimin e dukurive ekonomike, nevojat dhe dëshirat e pakufizuar, resurset e pamjaftueshme -rrallësinë, kompromisin, zgjedhjen dhe sjelljen e vendimeve. Më vonë studentët do të njihen me konceptet tjera bazike sikurse janë: kostoja oportune dhe kufiri i mundësive të prodhimit kërkesa dhe oferta, faktorët e prodhimit, sistemet ekonomike dhe ciklet ekonomike. Në vazhdim trajtohen çështjet e rëndësishme si treguesit makroekonomik, inflacioni, papunësia, kostot e prodhimit, etj. Pjesa e fundit në këtë lëndë trajton çështjet nga biznesi duke filluar me kuptimin e biznesit të vogël dhe ndërmarrësisë, organizimi dhe zgjerimi i tij dhe përfundon me temën mbi ndërvarësinë dhe dobinë nga tregu ndërkombëtar.

• **Parimet e marketingut**

Lënda ka për qëllim krijimin, zhvillimin dhe avancimin e dijeve të studentëve në lëmin e Marketing, si fundament i funksionimit të një biznesi të çfardo industrie qoft. Njëpërmjet të kësaj lënde studentët do të pajisen me njohuritë bazike rreth koncepteve dhe parimeve të marketingut; - Të aftësojë studentët për manaxhim të kërkimeve të tregut, segmentimeve të tregut, prezantimit të raporteve, etj. duke pasur parasysh nevojat, dëshirat dhe sjelljet e konsumatorëve;; - T'i njoftoj studentët me mjedisin e marketingut, në realitet me faktorët e makro dhe mikro mjedisit, të cilët drejtëpërdrejtë ndikojnë në suksesshmërinë e afarizmit të ndërmarrjes. - Profesionalisht t'i pregadis studentët në zbatimin, që do të thotë implementimin dhe organizimin e konceptit të marketingut në organizatë përmes elementeve të marketing miksit.

• **Mikroekonomia**

Lënda e ka për qëllim që t'i njoftojë studentët me principet dhe konceptet e Mikroekonomisë, e cila do t'ju mundësojë dhe aftësojë studentët e Biznesit dhe të Ekonomisë me mjete dhe teknika analitike të domosdoshme që të analizojnë dhe të japin zgjedhje çështjeve relevante dhe aktuale në sferën e Mikroekonomisë. Kjo lëndë do t'i aftësojë studentët me njohuri teorike dhe praktike si vijon: - Analiza e kërkesës dhe ofertës dhe ekuilibri i tregut; - Elasticiteti dhe aplikimi i tij, - Analiza e kostove dhe aplikimi i tyre; - Analiza e maksimalizimit të profitit në të gjitha llojet e konkurrencës; - Konkurrenca e plotë dhe jo e plotë dhe - Qeveria dhe mikroekonomia.

• **Kalkulus**

Lënda e Kalkulusit ka për qëllim që t'i zgjerojë njohuritë themelore nga matematika dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të studentët për zgjidhjen dhe aplikimin e problemeve përmes modeleve funksionale, njehsimit derivatit dhe integralit në fushën e biznesit dhe ekonomisë. Temat që trajtohen në këtë lëndë janë: Kuptimi i funksionit me një ndryshore, funksionet elementare, modelet funksionale, limiti dhe vazhdueshmëria e funksionit, kuptimi i derivatit, rregullat e derivimit, elemente të analizës marginale, derivatet e rendeve të larta, derivati i funksionit të përbërë, monotonia dhe vlerat ekstreme të funksionit, konkaviteti dhe pikat e funksionit, analiza dhe paraqitja e grafikut të funksionit, kuptimi dhe përkufizimi i integralit të pacaktuar, vetitë dhe rregullat e integralit, metodat e integritit, zbatimin e integralit të pacaktuar në biznes dhe ekonomi, kuptimi dhe përkufizimi i integralit të caktuar, vetitë e integralit të caktuar, njehsimi i integralit të caktuar, zbatimin e integralit të caktuar në biznes dhe ekonomi.

- **Komunikimi verbal**

Qëllimet e programit lëndor: -Të zhvillojë aftësitë e komunikimit verbal. -Të jetë në gjendje të përfshihet aktivisht në një diskutim mbi një temë të veçantë. -Të zotërojë teknikat për komunikim të suksesshëm. -Të shprehin mendimin e tyre kritik për tema të caktuara. -Të zbatojnë teknikat e adaptuara në karrierën e tyre profesionale.

- **Statistika**

Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të njihen me analizën e të dhënave numerike nga një perspektivë shkencore edhe e atë: - Te dhenat, matja dhe statistika - Treguesit deskriptiv statistikor - të thjeshtë; - Treguesit deskriptiv statistikor - të grupuar; - Treguesit deskriptiv statistikor - të ponderuar; - Probabiliteti; - Variabla e rastësishme dhe distribucionet diskrete të probabilitetit; - Vleresimi intervale; - Testimi i hipotezave statistikore-mbi mesataren; - Korelacioni dhe regresioni.

- **Makroekonomia**

Lënda ka për qëllim krijimin, zhvillimin dhe avancimin e dijeve të studentëve në lëmin e Makroekonomisë, si fundament i funksionimit të një ekonomie kombëtare dhe një nënsistem i sistemit globale ekonomik. Nëpërmjet të kësaj lënde studentët do të pajisen me njohuritë bazike makroekonomike rreth: - prodhimit të brendshë bruto (PBB); - ofertës dhe kërkesës agregate; - investimeve dhe konsumit; - inflacionit; - papunësisë; - buxhetit shtetëror; - borxhit publik; - politikës monetare dhe fiskale, - marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare (bilanci tregtarë dhe i pagesave), etj.

- **Biznesi, Qeveria dhe Shoqëria**

Lënda ka për qëllim t'i pregatit studentet për mënyrat në të cilat mjedisi, veçanërisht politika qeveritare, ndikon në biznes dhe se si subjektet ekonomike dhe grupet e tjera të veçanta të interesit krijojnë dhe ndryshojnë rregullat e lojës në të cilën ata veprojnë. Në ekonominë e sotme, një strategji e suksesshme biznesi do të thotë më shumë sesa tejkalimi i kompanive rivale; menaxherët gjithashtu duhet të hartojnë strategji për t'u ballafaquar me forcat globale. Menaxherët duhet të kuptojnë se si bëhet politika publike dhe si palët e interesuara specifike, përfshirë edhe biznesin e tyre, mund të ndikojnë në procesin e politikave. Në këtë lëndë studentet do të krijojnë njohuri lidhur me: - Menaxhimi i çështjeve publike dhe marrëdhëniet me palët e interesuara, - Përgjegjësin sociale e ndërmarrjes; - Biznesin në botën e globalizuar, - Etikën, gjykimin etik dhe menaxhimi etik - Marrëdhëniet biznes-qeveri - Ndikimi në mjedisin politik. - Zhvillimi i qëndrueshëm dhe biznesi global - Rregullimi dhe menaxhimi i teknologjisë së informacionit

- **E drejta tregtare**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri të thelluara në fushën e të së drejtës tregtare. Në këtë drejtim, studentët në këtë lëndë do të jenë në gjendje që të kuptojnë mbi: - Rregullat ligjore për të kryer një veprimtari afariste, mënyrën e organizimit të subjekteve të biznesit, kushtet për krijimin dhe regjistrimin e subjekteve afariste dhe pronarëve individual si dhe mënyrat e ndërprerjes së subjekteve afariste; - Mënyrat për të krijuar një marrëdhënie juridike biznesi, kushtet për shfaqjen e atyre marrëdhënieve, efekteve dhe pasojave; - Aktivitetet lidhur me tregtimin me letra me vlerë; - Mënyra për të mbrojtur të drejtat e pronësisë industriale, mënyra për të mbrojtur subjektet afariste nga konkurrenca e jolohale; Mënyrat e mbrojtjes së konsumatorëve, etj.

- **Parimet e kontabilitetit**

Qëllimi i lëndës është që të ndihmon studentët të kuptojnë thelbin e kontabilitetit; të mësojnë konceptet dhe parimet bazë të kontabilitetit. Në këtë drejtim, lënda synon që studentët të marrin dije dhe kuptim për pasqyrat financiare, zërat bilancor të tyre, rregullat bazë të regjistrimit të dhënave kontabël, parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit, etj.

- **Menaxhimi i operacioneve**

Lënda ka të bëjë me shpjegimin teorik dhe praktik të operacioneve të nevojshme dhe të domosdoshme për menaxhimin efikas të funksionit planifikimit, organizimit, drejtimin dhe kontrollit të burimeve të një biznesi që nevojiten për të prodhuar produkte dhe shërbime me qëllim të realizimit të përfitimeve sa më të mëdha. Ju ofrohen njohuri hyrëse, mjaftë të kompletuara, të përmbledhura dhe të azhurnuara lidhur me vendin dhe rolin e menaxhimit të operacioneve në menaxhimin efikas të bizneseve dhe të aftësohen për aplikimin praktikë të kornizës teorike dhe profesionale që ka të bëjë me menaxhimin e operacioneve në bizneset bashkëkohore prodhuese dhe shërbuese. Studentët pritet që: - të kuptojnë çka përfaqëson menaxhimi i operacioneve, cili është roli i menaxhimit të operacioneve në biznes, të bëjnë dallimin në mes të karakteristikave të ndryshme të proceseve të operacioneve. - të kuptojnë çka është strategjia e operacioneve dhe të bëjnë dallimin në mes të prioriteteve konkurruese dhe fituese të një biznesi. Të kuptojnë se pse është i rëndësishëm projektimi i procesit të produktit apo shërbimit dhe cilat janë fazat e projektimit. - të kuptojnë çka nënkupton parashikimi i kërkesës dhe si duhet të bëhet planifikimi i kapacitetit

dhe projektimi i sistemit të punës. - të vlerësojnë rëndësinë për mbijetesën e bizneseve në ekonominë globale. - të jenë në gjendje që të ndërtojnë koncepte të pavarura lidhur me menaxhimin e operacioneve në bizneset prodhuese dhe shërbyese përmes hulumtimeve dhe përgatitjes së projekteve hulumtuese profesionale nga kjo fushë.

- **Menaxhmenti i burimeve njerëzore**

Qëllimi i ëndës është t'i njoftojë studentët me rolin dhe rëndësinë e menaxhmentit të burimeve njerëzore në organizatat bashkëkohore të biznesit. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri lidhur me menaxhmentin e procesit të burimeve njerëzore, si në teorinë ashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimi i Menaxhmentit.

- **Ekonomia për menaxher**

Lënda ofron një përmbledhje të teknikave ekonomike dhe qasjeve analitike në dispozicion të menaxherit për vendimmarrjen e biznesit. Ajo përfshin tema të tilla si përcaktimi i çmimit, parashikimi, analiza e kërkesës, analiza e prodhimit dhe kostos, por edhe politikat makroekonomike që ndikojnë në mjedisin e biznesit. Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë një perspektivë ekonomike që është e përshtatshme për studentët që aspirojnë të menaxhojnë njësi biznesi ose kompani të tëra në një larmi të madhe të industrive. Lënda bën pjesë në mikroekonominë e aplikuar. Mikroekonomia është themeli i të gjitha analizave ekonomike. Kjo lëndë do të paraqesë postulatet themelore të mikroekonomisë dhe do të ilustrojë implikimet e përhapura të këtyre postulateve kur ne shqyrtojmë situatat e botës reale. Qëllimi i kësaj lënde është që çdo student të "mendojë si një ekonomist" dhe të ndihet mjaft mirë në njohuritë mikroekonomike, për ta zbatuar atë në të gjitha sferat e jetës. Më detajisht, objektivat përfshijnë: - Zhvillimi i teknikave për vendimmarrje të dobishme biznesore; - Studimi i hollësishëm i teorisë së çmimeve dhe zgjedhjes së konsumatorit; - Studimi i struktures dhe performancës së tregut; si dhe - Konsiderimi i problemeve të biznesit nga perspektiva ekonomike.

- **Sistemet informative të biznesit**

Lënda u jep studentëve një hyrje në rolin e kompjuterëve dhe teknologjive të tjera të informacionit në biznes. Njohuritë konceptuale kompjuterike janë fokusi i kësaj lënde. Pas prezantimit të koncepteve themelore të përdorimit të kompjuterit, këto leksione i kushtojnë vëmendje të veçantë inovacionit aktual teknologjik në mjediset shoqërore dhe të biznesit. Temat përfshijnë teknologjinë dhe ndryshimin organizativ, telekomunikacionin, privatësinë në epokën e informacionit dhe sigurinë e biznesit në internet.

- **Kontabiliteti financiar**

Lënda ka për qëllim të përgjithshëm avancimin e dijeve dhe shkathtësive të studentëve në lëmin e llogaritarisë ndërsa si qëllim të veçantë ka rumbullaksim të njohurive në sferën e kontabilitetit financiar dedikuar shoqërive tregtare të sektorit të biznesit në pajtueshmëri me SLK dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK). Zbatimi i parimeve të kontabilitetit të dyfishtë duke aplikuar parimet e planit kontabel për bizneset në Maqedonin e Veriut në rastin e regjistrimit të AAGJ dhe AASH, shpenzimeve dhe të hyrave, regjistrimin e detyrimeve dhe kërkesave fiskale dhe përcaktimin e rezultatit financiar me llogarin vjetore në pajtim me SLK dhe SNK. Përpilimi i Pasqyrave Financiare si produkti final i Kontabilitetit Financiar është produkt shumë i rëndësishëm kontabel, financiar dhe ekonomik për bizneset ekonominë dhe shtetin.

- **Komunikim me shkrim**

Qëllimet e programit të lëndës: -Të fitojë njohuri në lidhje me procesin e shkrimit (fazat në krijimin e një teksti). -Të miratojë normat standarde të gjuhës. -Të arrihet një nivel akademik për shprehje me shkrim në shqip, maqedonisht ose anglisht, i cili do të zbatohet njohuritë e marra më parë të gjuhës standarde. -Të inkurajojë motivimin e studentëve për shprehje me shkrim pavarësisht nga llojet dhe format e tekstit. -Të miratojë kriteret e tekstualitetit, të cilat janë thelbësore për një tekst. -Të fitojë aftësi për kërkimin e materialeve (biblioteka dhe burimet në internet).

- **Financat publike**

Lënda ka për qëllim t'i analizoj politikat e ndryshme fiskale të aplikuara në një ekonomi edhe atë duke i analizuar ato në pikë referimi me politikat fiskale të vendeve tjera. Po ashtu, t'i analizoj aspektet fiskale dhe reflekset e reperkusionet e tyre në një ekonomi, efektet e ndryshme makro dhe mikroekonomike të politikave të ndryshme fiskale (restriktive, fleksibile, relaksuese, etj), si dhe t'u mundësojë studentëve të krijojnë një kuptim real mbi nevojën e tatimit si „një e keqe pa të cilën s'bëhet“, por që mundë të krijojë mirëqenie shoqërore poqëse menaxhohet drejtë dhe me efikasitet. Qëllimet e lëndës janë: - paisja e studentëve me njohuri nga Financa Publike, si një nga shtyllat kryesore të politikave makroekonomike dhe instrument fundamental i funksionimit të një ekonomie kombëtare si një tërësi dhe si nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit. - paisja e studentëve me njohuri në lidhje me të mirat publike dhe shpenzimet për sigurimin e tyre, eksternalitetet, rishpërndarjen e të ardhurave shoqërore, alokimi dhe rialokimi i të ardhurave, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet për ato, Analiza Kosto-Përfitime, sistemi i të ardhurave shoqërore,

sistemi i tatimeve dhe struktura e tyre, aspektet krahasimore të financave publike në vendet e zhvilluara dhe në ato të tranzicionit, specifikat e sistemit fiskal të Maqedonisë, trendet dhe sfidat e tij, decentralizimi fiskal, etj. - pajisja e studentëve me dituri të nevojshme profesionale në lidhje me buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore si instrumente kryesore të politikës fiskale, procedurat e përgatitjes, përpilimit, miratimit, zbatimit dhe kontrollit buxhetor si dhe me teknikat e parimet e menaxhimit të buxhetit në funksion të menaxhimit eficient të buxhetit si në rafsh qëndror poashtu edhe në atë lokal. - krijimi i një pasqyre të qartë të studentët për funksionimin e një sistemi fiskal duke ju dhënë pika referimi në aspekt të teorive të ndryshme fiskale me çka do të munden në mënyrë komparative të bëjnë dallimet dhe të gjejnë piktakimet e funksionimit të këtyre sistemeve në vende të ndryshme. - njoftimin e studentëve në mënyrë informative për indikatorët kryesorë të politikës fiskale në RMV, krijimi i një baze reale të të dhënave në lidhje me trendet afatgjate fiskale në Maqedoni duke i stimuluar ato të punojnë punë të pavaruara seminarike dhe ese nga lëmia fiskale.

- **Kontabiliteti menaxherial**

Lënda ka për qëllim të aftësohen studentet të zbatojnë metoda të reja më analitike në llogaritjen, analizën, buxhetimin, kontrollin dhe vlerësimin e kostove, të ardhurave dhe profitit të kompanisë në funksion të vendimmarrjes efektive dhe efikase në sektorin privat të ekonomisë, në sektorin publik dhe në sistemet organizative të tjera.

- **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**

Lënda ka të bëjë me shpjegimin teorik dhe praktik të zinxhirit të furnizimit të nevojshme dhe të domosdoshme për menaxhimin efikas të funksionit planifikimit, blerja, kontrolli i inventarit, transporti dhe magazinimi. Studentët do të mësojnë rreth temave të tilla si dizajni i rrjeteve të furnizimit dhe shpërndarjes në përputhje me biznesin e firmës dhe strategjinë e zinxhirit të furnizimit si dhe përmirësimin e performancës së zinxhirit të furnizimit përmes teknikave SCOR, Lean dhe Six Sigma. Studentët eksplorojnë sesi aspekte të ndryshme të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit janë të integruara brenda firmës, si dhe koordinohen me furnitorët, partnerët tregtarë dhe ofruesit e logjistikës / Transportit për të ofruar kënaqësi superiore të klientit. Marrja e vendimeve të shëndosha strategjike dhe taktike të mësuara duke menaxhuar një zinxhir global të furnizimit me elektronikë të konsumatorit përmes një simulimi on-line.

- **Marketingu strategjik**

Lënda shqyrton temat në strategjinë e marketingut. Strategjia e marketingut ka të bëjë me atë se si të menaxhojmë klientët në mënyrë që të maksimizojmë fitimet në kompani. Thexsi i lëndës do të jetë në mënyrën e menaxhimit strategjik të procesit të shënjestrimit, përfitimit, mbajtjen dhe rritjen e klientëve. Lënda do të shqyrtojë menaxhimin e strategjisë dhe organizatës për të ndërtuar klientë të vlefshëm për rritjen dhe fitime të ndërmarrjes. Do të diskutohen raste studimi në lidhje me problemet e një firme në secilin modul në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zbatojnë konceptet e mësuara, si dhe strategjitë që do të zbatohen në secilën situatë e dhënë.

- **Strategjia dhe organizimi**

Lënda është koncipuar në mënyrë që të ju mundëson studentëve të vlerësojnë dhe zbatojnë elementet kryesore të analizës strategjike, të zgjedhin strategjinë e duhur brenda një plani fleksibël dhe të inkurajojnë të menduarit për problemet që lidhen me zbatimin e strategjisë së formuluar të organizatës. Qëllimi i kësaj lënde është të mësojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për çështjet dhe problemet që lidhen me zgjedhjen e një strategjie në një mjedis të trazuar dhe dinamik dhe të kuptojnë se nuk ka një mënyrë të vetme të duhur për të zhvilluar një strategji.

- **Financat e korporatës**

Lënda ofron një hyrje në bazat e financave, duke theksuar zbatimin e tyre në një gamë të gjerë situatash të botës reale që përfshijnë financat personale, vendimmarrjen e korporatave dhe ndërmjetësimin financiar. Konceptet dhe aplikacionet kryesore përfshijnë: vlerën në kohë të parave, shkëmbimin kthim-rrezik, koston e kapitalit, normat e interesit, kursimet e pensionit, financimin e hipotekës, buxhetimin e kapitalit, vlerësimin e asetëve, normën e brendshme të kthimit, afatin e ripagimit, etj. - Temat e përfshira janë: - Hyrje në financat e korporatave - Vlera në kohë e parasë - Obligacionet dhe vlerësimi i tyre - Aksionet dhe vlerësimi i tyre - Vlera aktuale neto dhe rregullat e tjera të investimit - Vendimmarrja për investime kapitale - Kthimet dhe rreziqet: Modeli i Çmimit të Kapitalit (CAPM) - Rreziku, kostoja e kapitalit dhe buxhetimi i kapitalit - Vendimet e financimit të ndërmarrjeve dhe tregjet efikase të kapitalit

- **Paratë, bankat dhe tregjet financiare**

Lënda ofron një hyrje në parimet e parave, bankave dhe tregjeve financiare. Përmbytja e lëndës ka të bëjë kryesisht me studimin e strukturës dhe funksioneve të sistemeve financiarë. Përqëndrimi do të jetë në secilin nga tre entitetet kryesore që përbëjnë një sistem financiar: ndërmjetësuesit financiarë, letrat me vlerë dhe tregjet financiare. Në vazhdim do të studijohet ndryshimi në rëndësinë relative të ndërmjetësve financiarë dhe tregjet financiare në gjithë botën, dhe kështu propozohet një analizë historike dhe ekonomike e arsyeve të shfaqjes së sistemeve të

bazuara në banka dhe sistemeve të bazuara në tregje në vende të ndryshme.

- **Biznesi ndërkombëtar**

Lënda përfshinë tema të cilët ngërthejnë në vete tema të biznesit që zhvillohet jashtë kufijve shtetërorë. Në fillim realizohen tema me të cilët studentët njihen me njohuritë bazike nga kjo lëmi duke filluar nga ato se çka paraqet biznesi ndërkombëtar, pse mësohet biznesi ndërkombëtar, dallimi midis biznesit vendor dhe atij ndërkombëtar, pse biznesi ndërkombëtar është më i vështirë se ai vendor, etj. Në vijim temat që trajtohen në këtë lëndë janë: biznesi ndërkombëtar në epokën e globalizmit, dallimet kombëtare në ekonominë politike, ndryshimet në kulturë, IHD dhe integritet ekonomike rajonale. Në pjesën e dytë përfshihen temat që kanë të bëjnë me veprimet në BN siç janë: strategjitë e BN, organizimi i punës ndërkombëtare, strategjitë e hyrjes në biznesin ndërkombëtar, eksporti, importi dhe këmbimi, drejtimi i marketingut global dhe menaxhimi global i burimeve njerëzore.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshem për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Македонски јазик средно ниво 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun

përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë angleze 1**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financat, për diploma universitare, për shkathtësi të punës, për avansimin e tyre personal, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe apo ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të kursit, prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vectorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumësit, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 2**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financa, për diploma universitare, për shkathtësi pune, për avansimet e tyre personale, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe ose ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të kursit prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vectorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumësit, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 3**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të

semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përbushjen e nevojave të një tipi real: të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve për fenomene të ndryshme duke përfshirë krimin dhe katastrofat natyrore, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë, të vlerësojnë përparimin e tyre personal, të marrin pjesë në role dhe dialogje për tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ese për temat në lidhje me temat e materialit të lëndës. Në fund të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B1 të kornizës së përbashkët Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave. Studentët duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe gjendjen martesore dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin në lidhje me gradat universitare dhe arsimin universitar, artin, udhëtimin dhe sportin.

• **Gjuhë angleze 4**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përbushjen e nevojave të një tipi real; të pyesin dhe të japin përgjigje për identifikim personal dhe marrëdhënie personale; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre të përditshme, kohën e lirë, argëtimin, mjedisin e financave, problemet; të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat. Pas përfundimit të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B2 të kornizës së përbashkët Evropiane; Ata pritet të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të mundën të zbatojnë disa nga funksionet gjuhësore të mëposhtme: të japin këshilla; të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë.

• **Gjuhë angleze 5**

Gjuha angleze për qëllime akademike është lëndë me kohëzgjatje prej një semestri. Qëllimet e lëndës janë t'u mundësojë studentëve të fitojnë aftësi të cilat do u ndihmojnë mësimnxënien e tyre gjuhësore dhe përparimin e tyre gjuhësor në një mjedis akademik të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Kursi duhet ti aftësojë të përdorin këta aftësi edhe në orë të gjuhës së huaj si edhe në përparimin akademik në fushat e përmbytjes. Kursi përfshin aftësi gjuhësore, studiuese dhe në përgjithësi aftësi zbatuese (dëgjim, dhënie të prezantimeve me gojë, argumente konstruktive) në detyra të veçanta. Për këtë arsye, pas përfundimit të suksesshëm të kursit, niveli i zotësisë së gjuhës duhet të jetë në nivelin C1 sipas kornizës së përbashkët Evropiane. Si rezultat, studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë të suksesshme prezantime orale, të marrin pjesë në tribuna të debateve/diskutimeve online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe tu japin të tjerëve informacion kthyes në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe lexojnë thelbin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke shprehur mendimet e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese që zgjidh problemin. Ata duhet të jenë në gjendje të prezantojnë informacion pamor në formën e prezantimit poster në Power Point. Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe faktet mbështetëse në një tekst dhe të analizojnë dhe identifikojnë fjalorin kryesor të temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe të zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

• **Anglishtja e biznesit 1**

Studentët, do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

• **Anglishtja e biznesit 2**

Studentët, do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

• **Kapituj të zgjedhur nga shkathtësitë e TI**

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'ua tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe dizajnin e punimeve të ndryshme gjatë studimeve. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri mbi shkathtësitë e TI, që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore, profesionale dhe prezantime. - Të aftësojë studentët për zbatimin praktik të shkathtësive të TI.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727.

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Krijimi i ueb-it**

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i nje ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kerkon njohuri të gjuhës Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për të lejuar krijuesit të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks gjithashtu mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitete që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i medimeve digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design.

- **Google aplikacione për edukim**

Përmbledhje konceptuale me udhëzime praktike për shfrytëzimin e potencialit arsimor të G Suite. Kjo i identifikon parimet e të mësuarit që e mundësojnë përdorimin efektiv të G Suite për të krijuar mjedise mësimore që rrisin komunikimin arsimor. Ky kurs është i organizuar në një seri modulesh. Modulet janë të bashkangjitur në një meni përmbledhëse, të cilat mund të qasen në faqen "Google" për edukim, e cila i organizon modulet me po të njëjtën radhitje me të cilën do të diskutohen në klasë.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë me interes shkencor. Lënda: Hyrje në administrimin publik duhet t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet themelore të administratës publike. Kujdes i posaçëm do t'i kushtohet ofrimit të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe të reformave të parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësi të njoftohen dhe në mënyrë kritike t'i analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Meqë lëmi i studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimin e institucioneve të administratës publike, shërbimet e administratës publike, vendimmarrjen në AP.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe

udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Shkrimi dhe arsyetimi ligjor**

Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të drejtësisë dhe të kriminalistikës të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj). Për studentët e drejtësisë, kjo lëndë është më se e nevojshme që të përfitojnë shkathhtësitë e shkrimit të duhur juridik, si dhe të arsyetimit të duhur të asaj që e shkruajnë juridikisht, sepse mjeshtria e të shkruarit juridik është thelbësore për çdo jurist në punën e tij të ardhshme profesionale.

- **Teknologjia reproduktive e asistuar dhe e drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim të theksojë faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia reproduktive e asistuar dhe e drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për reproduktimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të reproduktimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: insimin artificial, in vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, reproduktimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritet nga studentët që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për reproduktimin e qenies njerëzore.

- **Dhuna në familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imune ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkrimohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Hyrje në shkenca kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda

mbulon tema siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

• **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

• **Probabiliteti dhe statistika e zbatuar**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënie e konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

• **E-tregtia**

Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët me konceptet themelore dhe me terminologjinë e e-tregtisë (e-commerce): ● historinë e e-tregtisë ● e-botën: e-biznesin dhe e-tregtinë ● modelet e biznesit për e-tregtinë ● sistemet e pagesave online ● marketingun online ● e-infrastrukturat. - T'u mësojë teknologjitë kryesore të cilat janë të detyrueshme për të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, "cookies", etj. - Të bëhet aplikimi i konceptit "e-commerce" nga teoria në praktikë duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. - Të sqarohet kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani Ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese / payment gateway). - Studenti të jetë në gjendje ta aplikojë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. - Studenti të jetë në gjendje t'i dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. - Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. - Studenti të jetë i njohur me internet dhe "cloud" shërbimet.

• **Hyrje në sistemet e informacionit**

Qëllimet e kësaj lënde janë: 1. të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e sistemeve të informacionit: a. Konceptet themelore të sistemeve të informacionit: hardueri, softuerie, rrjetet; b. E-World: e-biznes dhe e-commerce; c. Zhvillimi i proceseve; 2. Të mësohen sistemet e informacionit dhe të teknologjive që përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme brenda organizatave; 3. Aplikimi i IS koncepteve në disiplina të ndryshme drejtuese, gjatë analizës, interpretimit, vlerësimit dhe vendimeve; 4. Kuptimi i procesit të ridizajnit të organizatave duke përdorur sistemet e informacionit; 5. Përshkrimi i rolit të sistemeve të informacionit në vendimmarrje; 6. Shqyrtimi i sigurisë së informacionit, etikës dhe çështjeve sociale; 7. Njoftimi me internet, tregtinë elektronike dhe e-biznesin; 8. Përgatitja e studenteve për të punuar në projekte të vogla, puna individuale apo grupe, të cilët nga natyra mund të bien në këto kategori: studimet e rastit, projektit kërkimor shkencor, projekte zhvillimore ose projekte praktike;

• **Etika profesionale e TI**

Lënda siguron qasje gjithpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtruara në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i TI-së.

• **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda gjuhë shqipe me kulturë shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për

vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore(plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuhë gjermane 1-4**

Me përfundimin e lëndës nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Multikulturalizmi në mësimdhënien e gjuhës angleze**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi: Studentët pritet të jenë në gjendje të prezantojnë opinionet e tyre në lidhje me kulturën dhe globalizimit dhe e gjithë kjo reflektohet në procesin e arsimit. Pritet të diskutohen tema lidhur me tolerancën, mirëkuptimin, dhe akomodimin e diversitetit. Ata gjithashtu do të punojnë drejt përgatitjes të eseve ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipeve, paragjykimëve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Krijimi i modeleve arsimore për bashkëpunim multikulturor dhe zbatimi i tyre në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Zhvillimi i një strategjie arsimore që do të tregohet e suksesshme në situata ku mund të ketë tensione në mesin e studentëve për shkak të mungesës së tolerancës. Aftësitë për të vlerësuar: Përpunimi i portofolit individual të bazuar në parimet e arsimit multikulturor dhe kapacitetit dhe identifikimi i rasteve kur ka mungesë tolerance, duke synuar zhvillimin e frymës së bashkëpunimit ndërkulturor. Njohuri dhe mirëkuptim: Njoftim me parimet themelore të kulturës, relativizmit kulturor, arsimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe adresimi i këtyre çështjeve në kuadrin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Aftësitë e të mësuarit: Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Arsyetime dhe mendimi kritik**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që ta përmirësojnë mënyrën e tyre të menduarit, përmes të kuptuarit të strukturave të brendshme të procesit të menduarit dhe duke i rishikuar ato në kuadër të standardeve individuale dhe akademike. Ata do të zhvillojnë strategji të vendimmarrjes, të bazuara në reflektim, arsye dhe logjikë. Përmes kësaj lënde, studentët do të mësojnë se në bazë të cilave tendenca, ngjashmëri dhe supozime bazohen reflektimet e tyre, si dhe cilat kushte dhe pasoja lindin nga mënyra e tyre e menduarit. Ky mendim reflektues, nënkupton një rishikim aktiv, të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të të gjitha besimeve individuale në lidhje me fundamentin që i mbështesin ato dhe konkluzionet që dalin prej tyre. Studentët pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë vendime të kapshme, të nevojshme në mjedisin e përditshëm në lidhje me profesionet e tyre të ardhshme.

- **Marrëdhëniet me publikun dhe mediat e reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do të përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Media dhe shoqëria**

Mediat dhe shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Hyrje në ekonomi dhe biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP) si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Parimet e menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: - T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. - Të mendojnë në mënyrë efektive që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtejshme.

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit gjithnjë e më shumë kompani i përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'u përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimit, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negocimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhimi i projekteve**

Qëllimi lëndës që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të Menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës ose të idesë krijuese në një projekt real e të dokumentuar i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Plani i biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjësisë korporative sociale në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **Gjuhë frënge 1-2-3**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehjeje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajnë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

- **Gjuhë italiane 1-2-3**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja

është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmoj në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratat.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Arsimim online dhe digjital**

Lënda Arsimit Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatet në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Gjuhë angleze për bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lart. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Ky kurs, do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role, simulime, debate dhe diskutime.

- **Shkathtësi komunikuese në kontekst profesional në anglisht**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale në anglisht. Objektivat e lëndës përqendrohen në një gamë të gjerë mjedisesh dhe çështjesh profesionale. Studentët do të hulumtojnë procesin e analizës së situatave të ndryshme të komunikimit dhe në përputhje me rrethanat do t'i kuptojnë ato.

- **Beletristike dhe argëtim**

Lënda synon të eksplorojë një sërë tekstesh tërheqëse dhe të njohura letrare (romane, fragmente, lektura dhe tregime të shkurtra) në mënyrë që të kuptohen dhe shijohen karakteristikat e zhanreve të ndryshme të njohura, duke përfshirë trillimet shkencore, letërsinë për të rinj dhe fantastikën. Ndër objektivat e lëndës, mund të përfshihen me sa vijon: të zhvilluarit e vetëbesimit të studentëve, rrjedhshmërisë dhe interesit për të lexuar në anglisht, të lexuarit e llojeve të ndryshme të romaneve dhe dhënies së përgjigjeve të logjikshme dhe të mprehta, me gojë dhe me shkrim, duke krijuar një lidhje midis përvojës personale, njohurive globale dhe/ose burimeve të tjera (leksioneve, teksteve të leximit, filmave) dhe tekstit të caktuar. Për më tepër, qëllimet janë transferimi i aftësive të përparuar të leximit në

klasën e gjuhës së dytë dhe zhvillimi i këtyre aftësive, duke i bërë studentët lexues më të mirë në të dy gjuhët. Shkathtësitë e të lexuarit përfshijnë: përshkrimin, skanimin, parashikimin, të qëlluarit e fjalëve nga konteksti dhe leximin për një kuptim më të hollësishëm.

- **Letërsi angleze dhe filmi**

Kjo lëndë është e dedikuar për studentët e gjuhës angleze si dhe studentët që duan të lexojnë, të kënaqen duke parë filma dhe duke i analizuar ata. Qëllimet e lëndës janë si vijon: - të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit - diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike - analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese - diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët - paraqitja e perspektivave të ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore

- **Gjuha maqedonase për terminologji juridike dhe të BE**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për kompetencë dhe performancë gjuhësore në fushën profesionale (d.m.th. në fushën e të drejtës dhe BE-së). Bëhet fjalë për një koncept të përqendruar te studenti (learner-centered approach) e që thekson zhvillimin e aftësive të komunikimit në fusha specifike, d.m.th. thellimin dhe përforsimin e aftësive për shprehje të përparuar me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde maqedonase. Materiali i synuar përfshin përmbajtje në lidhje me disiplinat profesionale, si dhe dokumente dhe materiale autentike. Vëmendje e veçantë i kushtohet zotërimit të terminologjisë profesionale dhe zbatimit të saj në kontekst të përshtatshëm gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për një larmi temash, si dhe të fitojnë aftësinë për të komunikuar në gjuhën maqedonase në një mjedis shumëgjuhësh dhe multikulturor.

- **Ekonomia e integritimeve evropiane**

Lënda përfshinë një numër të temave të cilët kanë të bëjnë me çështje më të rëndësishme të ekonomisë së vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Objektivi kryesor i këtij programi është sigurimi i njohurive për ekonominë dhe proceseve integruese të shteteve anëtare të BE-së. Në fillim trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me përfitimin rolin, rëndësinë dhe përfitimet që ka integrimi ekonomik rajonal, dilemat dhe mendimet pro dhe kontra integruese, statet e integritimeve ekonomike rajonale, kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar për tu antarsuar në këto integritime ekonomike rajonale, etj. Më vonë temat që përpunohen janë të lidhura drejtpërdrejt me BE-në si njëra nga integritimet më cilësore sikurse janë: historikun dhe zhvillimin e BE-së, krijimin e tregut të përbashkët evropian, aktin unik evropian, krijimin e shteteve dhe politikave unike, krijimin e monedhës së përbashkët - euron, etj.

- **Financat lokale**

Financat Lokale ka për qëllim të sjell mënyrën e funksionimit të sistemit financiar në rastin e njësive të vetëqeverisjes lokale në tërësi, sfidat si dhe planet e veprimtimit në lidhje me mundësitë dhe rreziqet e pranishme në sistemin e financave të qeverisjes lokale (në komunat). Kjo lëndë ka për qëllim t'i informon studentët rreth: - financave publike të niveleve të ndryshme të qeverisjes; - qeverisjes së mirë dhe rolit të Këshillit komunal; - procesit të buxhetimit; - menaxhimit të borxhit publik (detyrimet dhe huamarrjet); - prokurimit publik, koncensionit dhe partneritetit publiko-privat; - përfshirjes dhe arkëtimit të taksave lokale; - pasqyrave financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale; - kontrollit financiar dhe auditimit në njësitë e vetëqeverisjes lokale; - menaxhimit të burimeve njerëzore në njësitë e vetëqeverisjes lokale, etj.

- **Tregu i punës**

Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë së tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda ka mision t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale, të cilët mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve, që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj, studenti për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme, që lidhen me tregun e punës.

- **Modelimi financiar**

Lënda ka për qëllim tu ofrojë studentëve kuptim themelorë për aspektet teorike dhe praktike të modelimit financiar. Krijimi i programit mësimor është inspiruar që të mundëson: -zhvillim të karrierës në hulumtime që lidhen me fondet investive, investimet në sektorin bankar dhe kompani të tjera të ndryshme, projekte financuese, analizë biznesore; -njohje me modelimin përmes Excel-it për analizë, vlerësim të kompanive të ndryshme dhe parashikim; -përgatitjen e hulumtimit financiar, analizën dhe vlerësimin e sektorëve të ndryshëm; -zbatimin e shkathhtësive të modelimit financiar në praktikën menaxheriale, etj.

- **Sistemi fiskal dhe monetar në UE**

Qëllimi i lëndës është që të aftësojë studentët e FBE me njohuri të mjaftueshme që të analizojnë dhe të hulumtojnë politikën monetare dhe fiskale në EU. Fokusi do të jetë në politikat mikro dhe makro të EU, me theks të vecantë në politikat monetare dhe fiskale të EU. Gjithashtu në këtë lëndë do të analizohen roli dhe rëndësia e politikave të përbashkta të EU zonës, me theks të vecante politikat e përbashkta që korespondojnë me politikën monetare dhe fiskale. Në fund fare lenda do t'ju mundësojë studentëve të FBE të përfitojnë njohuri të mjaftueshme për tregun e përbashkët dhe efektet e saja në rritjen ekonomike, politikën tregtare të EU, instrumentet makroekonomike të EU, integrimi monetar të EU, valuta e përbashkët në EU, dhe politika fiskale dhe pakti i stabilitetit në EU.

- **Ekonomia e mjedist jetësor**

Ekonomia e mjedisit jetësor synon që studentët të fitojnë njohuri për: - burimet kryesore dhe llojet e agjentëve mjedisorë; - hapat në procesin rregullator në drejtim të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut, si dhe njohuri për të identifikuar legjislacionin aktual dhe rregulloret në lidhje me çështjet mjedisore; - plotësimin e boshllëqeve në lidhje me efektet shëndetësore të agjentëve mjedisorë dhe identifikimin e fushave të pasigurisë në procesin e vlerësimit të rrezikut, si dhe - identifikimin dhe përcaktimin e hapave në procesin e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut.

- **Ekonomia e fondeve publike**

Ekonomia e Fondeve Publike ka për qëllim të sjell ndryshimet midis sektorit publik dhe atij privat, respektivisht organizimi dhe mënyra e funksionimit të sektorit publik në përgjithësi, e në veçanti në Republikën e Maqedonisë së Veriut. - Kjo lëndë ka për qëllim t'i informon studentët rreth: - rëndësisë dhe përmbajtjes së administratës së sektorit publik; - menaxhimit të aseteve publike; - menaxhimit financiar të sektorit publik dhe planifikimit strategjik të organizatave publike; - aktiviteteve prioritare për reformat në Ballkan; - sfidave në reformën e administratës publike; - menaxhimit të Fondit Pensional; - Agjencionit të Punësimit të RMV; - menaxhimit të mirë të fondeve publike, korrupsionit, etj.

- **Zhvillimi ekonomik lokal**

Përmes lëndës synohet që studentët të arrijnë: - të kuptojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse kompleksitetin e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe aspektet që përbëjnë portofolin e zhvillimit ekonomik lokal; - të vlerësojnë në mënyrë kritike avantazhet dhe disavantazhet që dalin nga mënyrat alternative të realizimit të zhvillimit ekonomik lokal; - të vlerësojnë rëndësinë e rrjeteve të krijuara ndërmjet palëve të interesuara në sektorin publik, sektorin e biznesit dhe qeverinë lokale, respektivisht komunat; - të zgjedhin instrumente shkencore për vlerësimin e strategjive të pranueshme për zhvillimin ekonomik lokal, etj.

- **Ekonomia globale**

Qëllimi i lëndës është prezantimi i drejtimeve kryesore të debateve në lidhje me rendin ekonomik bashkëkohor global. Në këtë kurs do të diskutohet konteksti ekonomik global, me fokus në globalizimin dhe proceset e integritit rajonal. Do të mbulohen gjithashtu trendet dhe institucionet kryesore në ekonominë globale, të tilla si sistemi monetar, tregu i këmbimit valutor dhe regjimi tregtar. Gjithashtu, korporatat transnacionale do të trajtohen në kuadër të këtij kursi, duke filluar nga ndikimi i IHD-ve në ekonominë e vendit dhe ato pritëse, deri te mënyrat e tranacionalizimit të bizneseve bashkëkohore.

- **Ekonomia e sigurimeve**

Përmes lëndës jepet kuptimi themelor për menaxhmentin e sigurimit. Studentët i përpunojnë aspektet teorike dhe i fitojnë shkathhtësitë dhe dituritë e nevojshme në sferën e menaxhmentit të sigurimit. Në kuadër të kësaj lënde janë përfshirë shkathhtësitë themelore që përdoren në organizatat moderne të cilat janë të lidhura me logjikën e proceseve të sigurimeve, planifikimit financiar, elementeve të sigurimeve, llojeve të sigurimeve etj. Vlerësimi është shkathhtësi e cila nevojitet për të gjithë menaxherët dhe për të gjitha disiplinat. Prandaj kujdes i veçantë i kushtohet drejtimin të mjeteve të qeverisjes, qeverisjes me riskun nga siguri, shfrytëzimi i teorisë dhe modeleve të gjasës për drejtimin efikas me rrethimin e veçantë të shoqatave të sigurimeve etj.

- **Sistemet ekonomike dhe politike**

Lënda ka për objekt studimi funksionimin e sistemit ekonomik kundrejt sistemit politik, në drejtim të aplikimit të politikave të përshtatshme ekonomike, kornizës ligjore dhe mundësive për reforma dhe transformim eventual të sistemit ekonomik dhe politik në funksion të rritjes dhe zhvillimit ekonomik adekuat të vendit drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Lënda Sistemi ekonomik dhe politik studentët i pajis me njohuri mbi parimet themelore të ekonomisë si një disiplinë shkencore, doktrinat ekonomike për zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm ekonomik përmes njohjes paralele të sistemit politik me aktorët përkatës në shoqëri. Lënda u mundëson studentëve të thellojnë njohuritë e tyre për sistemet ekonomike dhe politike moderne; rolin e shtetit dhe reformat strukturore; menaxhimin e institucioneve publike; sistemin fiskal, monetar dhe të tregtisë së jashtme si dhe menaxhimin adekuat të proceseve dhe reformave të nevojshme drejtë evoluimit të sistemit ekonomik e politik që do mundësoj rritje dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, me një theks të veçantë për RMV.

- **Ekonomia e sjelljes**

Qëllimi i lëndës është studimi i faktorëve social, kognitiv dhe emocionalë të vendimeve ekonomike individuale dhe institucionale, si dhe pasojat e ndryshimeve në çmimin e tregut, fitimet dhe alokimin e burimeve. Modeli i sjelljes është i integruar nga teoria ekonomike dhe përfshin një sërë konceptesh, metodash dhe fushash kërkimore.

- **Menaxhmenti i portfolios**

Lënda ka për qëllim të pajisë studentët me kuptimin themelor të menaxhimit të portfoliut. Rëndësi të veçantë i kushtohet letrave me vlerë, si dhe logjikës së përfitueshmërisë gjatë përzgjedhjes së të njëjtave në portfolin optimal investues. Andaj, lënda synon të pajisë studentët me shkathësitë, njohuritë dhe konceptet mbi të cilat ndërtohet filozofia e portfoliut; të kuptojnë nga pikëpamja teorike dhe praktike rolin që portfoli luan në vendimmarrjen afariste dhe kryesisht atë financiare si mjet dhe instrument për diversifikimin – menaxhimin e riskut; të kuptojnë lidhjen fundamentale risk-kthim; të kompozojnë një portfoli duke marrë parasysh riskun dhe kthimin e aktiveve; të njohin llojet e risqeve dhe kthimeve, dhe ti vlerësojnë të njëjtat përmes teknikave dhe modeleve të njohura (duke shfrytëzuar kryesisht Excel-in) ; të menaxhojnë portfolin dhe të matin performancën e portfoliut, etj.

- **Financat personale**

Lënda ofron një hyrje praktike të menaxhimit financiar personal. Duke përdorur një qasje të strukturuar, hap pas hapi, studentët mësojnë se si të kursejnë dhe investojnë, të menaxhojnë kreditë studentore, të paraqesin taksa, të ulin borxhin e kartës së kreditit dhe të planifikojnë për të ardhmen. Skenarët e jetës reale, duke mbuluar një gamë të gjerë sfidash financiare, u mundësojnë studentëve të vlerësojnë rëndësinë e koncepteve kryesore dhe këshillat e dobishme nga ekspertët e financave personale i ndihmojnë ata të zbatojnë ato koncepte në jetën e tyre. Shumë shembuj të bazuar në matematikë ilustrojnë qartë rëndësinë kritike të arritjes së qëllimeve financiare afatgjata përmes investimeve. Kursi i angazhon studentët dhe përqendrojnë vëmendjen e tyre në konceptet kritike që u duhen për të patur sukses në klasë dhe për të menaxhuar financat e tyre me mençuri për një jetë.

- **Principet e bankave dhe financave**

Lënda ofron një hyrje në parimet e bankave dhe financave. Ajo mbulon një gamë të gjerë temash duke përdorur një perspektivë ekonomike dhe synon të sigurojë një sfond të përgjithshëm për çdo student që do të ndjek lëndën. Lënda kryesisht do të shqyrtoj çështjet që vijnë nën titullin e gjerë të parimeve të bankave. Këtu trajtohen arsyet kryesore ekonomike të përdorura për të justifikuar ekzistencën e ndërmjetësve financiarë (dhe konkretisht të bankave). Më pas do të analizohet natyra e veçantë e rregullimit bankar. Në fund, do të përshkruahen rreziqet kryesore në bankë dhe metodat kryesore të përdorura për menaxhimin e rreziqeve. Kështu, fushat e përfshira mbulojnë rolin e ndërmjetësimit financiar, rregullimin bankar dhe menaxhimin e rrezikut bankar.